

# ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Paraqes një ankesë kundër:

**Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës**

**Sektori i Prokurimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	ZK104-25-2478-1-2-1
Nr i brendshëm	ZK104-25-006-1-2-1

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me karrige për zyre - ritenderim**

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**“MOBELLAND” SH.P.K.**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Rruga “Xhavit Sylja” p.n.**

*(Adresa)*

*(Vendi):* **Suharekë**

*(Kodi postar):* **23 000**

**049 606 379**

*(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it) /*

**Rizah Morina**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**info@mobelland.net**

*(Adresa elektronike)*

**15.05.2025**

*(Data e parashtrimit të kërkesës)*



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Ne kemi konkurruar në tenderin me titull: Furnizim me karrige për zyre - ritenderim me nr. të Prokurimit: ZK104-25-2478-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: ZK104-25-006-1-2-1 të shpallur me datë 26.03.2025, afati i fundit për dorëzimin e tenderit ka qenë me datë 16.04.2025 deri në ora 14:00. Hapja e tenderit është bërë me datën e njejtë duke filluar në ora 14:00. Njoftimin si tenderues i eliminuar e kemi marrë në vendimin e AK-s B58 të publikuar me datë 29.04.2025 ora 15:48.

Kërkesën për rishqyrtim të vendimit tek Autoritetit Kontraktues e kemi paraqitur me datën: 04.05.2025

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datën: 06.05.2025

Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë tendei i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.



Po ☐

Jo ☒

*Nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit, por me qenë se procesverbali na është dërguar përmes platformës elektronike nuk kemi pasur ndonjë vërejtje.*

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e metutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

*Njoftimin si tenderues i eliminuar e kemi marrë në vendimin e AK-s B58 të publikuar me datë 29.04.2025*

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

Autoriteti Kontraktues-Spektori i Prokurimit i Zyrës së Kryeministrit me datë 29.04.2025 ka publikuar dokumentin B58 me të cilën ka vendosur që të shpërblen me kontratë Operatorin Ekonomik "Galanteria" SHPK kurse neve me letren standarde na ka cilësuar si tenderues të pa përgjegjshëm për tenderin në fjalë.

Të pa kënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblim me kontratë të një O.E. të pa përgjegjshëm dhe me çmim më të lartë se oferta jonë, si dhe me vlerësimin jo të drejtë të tenderit në fjalë, duke u bazuar në nenin 10 të LPP-s kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik me ç'rast AK na ka dhënë qasje në dokumentet e kërkuara nga të cilat kemi vërejtur që O.E. i propozuar për kontratë ka dorëzuar tender të pa përgjegjshëm.

Duke u bazuar në nenin 108A të LPP-s, kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim të vendimit të AK-s, në të cilin kemi cekur se me rastin e vendimit Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-s të rregulluara me Nenin 1; 6; 7; 52; 56; 59; 60 dhe 70 të LPP-së si dhe Nenin 4; 37; 40 dhe 45.19 të Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Gjithashtu me kërkesën tonë, Duke u bazuar në nenin 108 A të LPP-s paragrafi 2, si dhe në rrethanat, faktet dhe dëshmitë e cekura më lartë, kemi kërkuar nga AK që automatikisht të pezullon zbatimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe kemi kërkuar nga AK-ja – ZPP që të merr:

#### VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e GOE: **Mobelland SH.P.K. ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-se B58 për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERESIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me



kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave ligjore të LPP-së ta rishqyrtoni vendimin me të cilin keni propozuar për kontratë OE-ik të pa përgjegjshëm dhe me çmim më të lartë se oferta jonë dhe të merrni parasysh dokumentet e ofruara në tenderin tone.

Gjithashtu e kemi paralajmëruar AK-n që nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga të gjitha palët që kanë marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

Mirëpo AK duke mos i marrë parasysh provat dhe faktet e paraqitura në kërkesën tonë me datën 06.05.2025 e refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim duke mos i marrë për bazë vërejtjet dhe faktet të cilat tregojnë se janë shkelur dispozitat ligjore të cekura në kërkesën për rishqyrtim pa dhënë ndonjë arësytim të bazuar dhe pa i shqyrtuar disa nga pretendimet tona të cilat janë dokumentuar me anë të fakteve dhe provave.

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë me nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mendojmë që Autoriteti kontraktues i ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:

Neni 1 i LPP-së

Nenin 6 të LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 52 par. 3 të LPP-së

Neni 56 par. 3 të LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 par. 1.1 të LPP-së.

Neni 70 par. 1.1 të LPP-së.

Neni 4 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 37 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 40 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 45.19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**



*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin në fjalë në të cilin ka paraqitur kërkesat për pjesëmarrje si dhe ka paraqitur kriterin për dhënie i cili ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ndërsa ne si Operator Ekonomik i jemi përgjigjur ftesës për tender duke e përgaditur tenderin dhe duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ana e AK-s.

AK – Zyra e Kryeministrit me date **29.04.2025**, përmes platformës elektronike e-prokurim ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK – B058 mirëpo me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale na eliminon ne kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-se, me arësytimin se:

☒ Kemi dështuar në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar:

Lidhur me pikën III. 2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale mbi mundësit teknike

dhe/ose profesionale, duhet të prezantoj:

1. OE duhet të ketë autorizim nga prodhuesi.
2. Kërkohej mostër e mallit me të cilin ofertohej

1. Mungon autorizimi nga prodhuesi – konform Nenit 69 të LPP mbi Aftësitë teknike dhe profesionale
2. Mostra e dorëzuar nuk i plotëson specifikat teknike - konform Nenit 28 të LPP respektivisht Nenit 19 të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për PP.  
Anësoret e karrigës 3D - me mundësi të lëvizjes së pozicionit (lartë/poshtë dhe majtas/djathtas) brendia nuk është e kromuar.

Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Sa i përket arësytimit të parë se kinse ne nuk e kemi plotësuar kërkesën III. 2.4 pika nr. 1 në të cilën është kërkuar që O.E. duhet të ketë autorizim nga prodhuesi, ne me tenderin tonë kemi dorëzuar deklaratën me shkrim me të cilën kemi deklaruar se ne kemi fabrikë prodhuese dhe se të gjithë artikujt e kërkuar i prodhojmë vetë apo e bëjmë importin dhe montimin e tyre. Pra ne nuk kemi si ta autorizojmë vetën pasi që ne jemi vetë prodhues dhe një gjë e tillë mund të vërtetohet shumë lehtë në certifikatën e beiznesit tonë në të cilin e kemi kodin për prodhimin e mobileve të zyrave dhe dyqaneve **3101** e në të cilin kod, hyn edhe prodhimi i karrigeve. Gjithashtu me tenderin tonë, kemi dorëzuar edhe certifikatat EN-1335 në të cilën është përshkruar qartë se ne jemi prodhues të karrigeve. Kjo certifikatë tregon që ne si prodhues i karrigeve i plotësojmë të gjitha standardet e kërkuara për karrige. Pra nuk ka logjikë dhe as bazë ligjore që të dikualifikohemi për autorizim të prodhuesit, kur ne jemi vetëprodhues të karrigeve dhe mobileve për zyre. Ne kemi konkurruar me qindra herë në tender të ndryshëm të cilët kanë kërkuar autorizim nga prodhuesi por asnjëherë nuk jemi eliminuar për autorizim nga prodhuesi pasi që njëjtë sikur në këtë rast kemi dorëzuar deklaratën që ne jemi vetëprodhues andaj ne mund t'i lëshojmë autorizim ndonjë O.E. i cili bënë tregëti me inventar për zyre por nuk kemi si ta autorizojmë vetëvehten për shitje të inventarit pasi që një e drejtë e tillë buron nga fakti që ne jemi prodhues dhe mund ti shesim produktet tona, si brenda e po ashtu edhe jashtë shtetit. Autoriteti Kontraktues me këtë rast na ka diskriminua si prodhues vendor i cili i bënë prodhimet në përputhje me të gjitha standardet e pranuar të vendit si dhe me standardet evropiane, pasi që po kërkon që të marrim autorizim nga ndonjë kompani e huaj edhe përkuandër se ne jemi vetëprodhues i mobileve për zyre. (fabrikë prodhuese e inventarit për zyre dhe mobiljeve tjera.) Andaj duke na eliminuar për autorizim për prodhimin e karrigeve, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 70 pasi që nuk e ka vlerësuar drejtë tenderin tonë edhe pse i kemi



dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara nga vetë Autoriteti Kontraktues e të cilat dëshmojnë që produktet tona janë në përputhje me standardet e kërkuara.

Konsiderojmë që konkluzioni i Autoritetit Kontraktues i paraqitur më lartë është vetëm arësyetim fiktiv me të cilin Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të tenderit, duke parë që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe kemi ofruar çmimin e tenderit më të lirë në mesin e tenderuesve të përgjegjshëm pjesëmarrës me qëllim që të na diskualifikon neve nga tenderi në fjalë dhe kontratën t'ia jep ndonjë O.E. të paracaktur, na eliminon neve nga ky tender.


Sa i përket mostrës së dorëzuar, Autoriteti Kontraktues pa të drejtë konstaton që mostra e dorëzuar nga ana jonë nuk i plotëson specifikat teknike të kërkuara nga AK me arsyetimin që Anësoret e karriges 3 D – me mundësi të lëvizjes së pozicionit (lartë/poshtë dhe majtas/djathtas) brendia nuk është e kromuar. Edhe ky është një arësyetim fiktiv vetëm për të na eliminuar pasi që mostra e dorëzuar nga ana jonë i plotëson të gjitha specifikat e kërkuara nga AK në dosje të tenderit. Autoriteti Kontraktues në specifikacion teknik ndër të tjera ka kërkuar që anësoret e karriges të jenë 3D me mundësi të lëvizjes së pozicionit (lartë/poshtë dhe majtas/djathtas) në brendi e kromuar dhe pjesa tjetër me material polipropilen. Ne kemi dorëzuar mostrën e karriges tonë në të cilën shihet qartë që anësoret e karriges janë 3 D si dhe materiali i brendshëm është metal i kromuar dhe pjesa e jashtme është e mbuluar me plastikë. Edhe fotografia e karriges të cilën e ka bashkangjitur Autoriteti Kontraktues është e njëjtë me mostrën e karriges tonë. Nga fotografia shihet që karrigia pjesën e brendshme e ka me metal të kromuar, ndërsa mbi metal është e mveshur me plastikë. Pasi që standardi e kërkonë një gjë të tillë. Gjithash në përputhje me legjislacionin e prokurimit dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit ne kemi dorëzuar edhe deklaratën për specifikacion teknik me të cilën kemi konfirmuar që produkti ynë i plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje kemi bashkëngjitur certifikatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi.

Konstatojmë që deri te eliminimi i jonë në lidhje me këtë pikë ka ardhur për shkak që AK nuk ka emëruar një komision të pavarur për inspektimin e mostrave sikur është kërkuar në nenin 37 të Rregullorës në fuqi të Prokurimit, por mostrat janë shqyrtuar nga komisioni i vlerësimit të tenderit të cilët nuk janë profesional në lëminë e inventarit dhe mobileve si dhe nuk e kanë paraqitur në mënyrë profesionale inspektimin. Andaj nuk është respektuar procedura e inspektimit të mostrave.

Ne me rastin e kërkesës për qasje në dokumente të tenderit kemi vërejtur që mostra e O.E. të rekomanduar për kontratë "Galanteria" SHPK nuk i ka plotësuar specifikat pasi që rrotat nuk e kanë dimensionin e njëjtë sikur është kërkuar tek specifikat teknike pasi që dimensionin e rrotave i kërkuar nga AK në specifika teknike ka qenë me diametër minimumi 65 mm ndërsa nga mostra e O.E. të rekomanduar shihet që diametri i rrotave është: 48 mm.

Shih foton e bashkangjitur gjatë matjes së specifikave të rrotave:





Gjithashtu në specifikat teknike të paraqitura në dosje të tenederit është paraparë që ulësja duhet të ketë shkurpë të kallupuar (shpuzë) ndërsa O.E. i rekomanduar ka ofruar karrige me shpuzë të thjeshtë e cila nuk është e kallupuar sikur është kërkuar në specifika teknike.

Gjithashtu në specifika teknike edhe shtofi është kërkuar të jetë me material shtof me mikrofibra, ndërsa shtofin të cilin e ka ofruar O.E. i rekomanduar është shtof i plastifikuar dhe jo me mikrofibra. Shih foto te shtofit me mikrofibra:





Gjithashtu pjesa e shpinës së karriges nuk është e lëvizshme dhe ergonomike sikur është kërkuar në specifika teknike. Gjithashtu nuk është rrjet por shtof i thjeshtë.

Shih foton e bashkangjitur me poshtë:



#### Karrigë Lëvizëse

##### Mekanizmi i sinkronizuar 3D

- Rregullimi i mbështetëses së shpinës në pozicione të ndryshme;
- Rregullimi i lartësisë së ulëses poshtë/lartë,
- Pjesa e mbështetëses nga korniza plastike, rrjetë antibakteriale, me pajisje lëvizëse shtesë ergonomike,
- Ulësja e mbështjellur me shumëllojshmëri të kallupuar (shpuze) poliuretane me dendësi min. 40 dns dhe pastaj e mbështjellë me stof microfibre ngjyrë të zezë.

##### Anësoret e karriges 3D

- me mundësi të lëvizjes së pozicionit (lartë/poshtë dhe majtas/djathtas) në brandi e kromuar dhe pjesa tjetër me material polipropilen.

##### Mekanizmi i përkuljes

- me dy krahë, amortizuesi i ngritjes me gas, bazamenti në formë ylli nga alumini ose plastika e zier (polipropilen) me diametër min. 65cm - 68cm, rrotat me diametër minimum 65 mm.

##### Ulësja - dimensionet e brendshme:

- thellësia min.49cm; gjerësia min.50cm; lartësia min. 43 cm - 56 cm

##### Mbështetësja

- lartësia min.54 cm; gjerësia min.50 cm
- pjesa për mbështetjen e qafës min. 30cm x 16cm

##### Dimensionet e jashtme të karriges

- gjerësia min.65cm; thellësia min 61cm; lartësia min.115 cm - 128 cm



Fotot vlejnë vetëm si orientim se si duhet afërsisht të duket karrigia.

Edhe nga një shikim i thjeshtë i mostrës së dorëzuar nga O.E. i rekomanduar shihet qartë që nuk i ka plotësuar specifikat e kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Sa i përketë kësaj pike Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së pasi që ka përdorur standarde të dyfishta. Pra këtu shihet qartë diskriminimi.

Gjithashtu, AK – Komisioni i vlerësimit ka vepruar edhe në kundërshtim me me **nenin 56 par. 3 të LPP-se**, ku thote, po citojm: *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e Tenderit”* që do të thote se me arsyetimin e eliminimit në njoftimin B58 ka vepruar në kundërshtim me kete dispozite ligjore duke dhënë arsye dhe pershkrime të pa sakta, duke na përjashtuar nga ky aktivitet i prokurimit me kërkesa dhe kriteret që nuk janë cekur në dosje të tenderit si dokument themelor për pergatitjen e tenderve.

Duke marrë bazë të gjitha keto fakte dhe argumente të cilat i kemi parashtruar në kete kërkesë për rishqyrtim (KpR) me fakte dhe argumente të bazuar në dispozita ligjore të LPP-se, kërkojmë nga AK – ZPP të konsultojë dispozitat ligjore, për kete AP të kete parasysh **nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-se** si dhe të kete parasysh parimin kryesor të prokurimit **“Vlerën për parë”** dhe të respektoj **nenin 31.1 të FDT-se** që është në funksion të nenit 60 të LPP-se, në përputhje me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit pasi që ne kemi arritë të plotësojmë të gjithë kërkesat dhe kriteret e përzgjedhjes dhe kemi tenderuar me çmimin më të ulët dhe kemi ofruar tender të përgjegjshëm në kete aktivitet të



prokurimit dhe bazuar ne dispozitat ligjore te LPP-se, AK ka per obligim te na rekomandoj per dhenie te kontrates. Sepse buxhetit të shtetit i shkaktohet dëm për kontratën e njejtë në vlerë prej 4,250.00 €.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se AK – ZPP ka shkelur **Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së** e parasheh qarte qe “*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të **nenit 1 të LPP-s** pasi që ka refuzuar ofertën tonë e cila ka qenë ofertë më e lirë ndërsa dispozitat e këtij neni kanë paraparë që qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në bazë të këtyre dispozitave Autoriteti Kontraktues duhet ta merr vlerën për paranë e që oferta jonë do ta plotësonte një kërkesë të tillë.

Shihet qartë që Autoriteti Kontraktues, duke e favorizuar O.E. të rekomanduar ka shkelur parimet bazike të prokurimit të cilat janë paraparë në nenin 4 të Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të plotësuar dhe ndryshuar me rregulloren nr. 001/2024 sikur janë:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.
- g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

Andaj favorizimi i një O.E. gjatë vlerësimit si dhe diskualifikimi i O.E. tjetër, paraqet shkelje të rëndë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të parapara në nenin 7 të LPP-s.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, AK ka bërë vlerësim jo të drejtë dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-s, pasi që na eliminon nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të paracaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Në dispozitat e paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-s shprehimisht është paraparë që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.



Andaj konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-s dhe Neni 40 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit, i cili në dispozitat e paragrafit 40.12 shprehimisht është cekur se: Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Ndërsa në paragrafin 40.13 ka paraparë që AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Andaj Autoriteti Kontraktues duke na eliminuar në mënyrë arbitrare ka bërë shkelje të këtyre dispozitave.

Nga qasja ne dokumente te tenderit kemi konstatuar që kryesuesi i komisionit të vlerësimit Shkelzen Ibrahim kishte bërë kërkesën për inicimin e procedurës së prokurimit si dhe kishte hartuar specifikacionin teknik duke ia përshtatur ato Operatorit Ekonomik të rekomanduar dhe gjithashtu ka marrë pjesë edhe në vlerësim gjë e cila është e ndaluar me Rr. Nr. 001/2022 PP të ndryshuar me Rr. 001/2024. Andaj ky anëtar i komisionit ka shkelur deklaratën nën betim e si pasojë ka bërë edhe shkelje të dispozitave të lartcekur. Gjithashtu si Derjtor i Administratës së ZKM-s ka ushtruar ndikim në anëtarët tjerë të komisionit duke i detyruar që të paraqesin një gjendje faktike të ndryshme nga ajo reale. Andaj ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare sespe kanë shkelur deklaratat nën betim me të cilat janë zotuar që të kryejnë vlerësimin në përshtatje me LPP dhe rregulloren e prokurimit .

Ministria e Shëndetësisë  
Kosovë

2024-09-10

**Përcaktimi i kriterëve për çmimin e kontratës**

Me referencë të: 1. Njoftimit për blerje të shërbimeve të shëndetësisë, 2. Njoftimit për blerje të shërbimeve të shëndetësisë, 3. Njoftimit për blerje të shërbimeve të shëndetësisë, 4. Njoftimit për blerje të shërbimeve të shëndetësisë, 5. Njoftimit për blerje të shërbimeve të shëndetësisë.

1. Të përcaktohet kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë.

2. Të përcaktohet kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë, i cili do të jetë kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë.

3. Të përcaktohet kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë, i cili do të jetë kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë.

4. Të përcaktohet kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë, i cili do të jetë kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë.

5. Të përcaktohet kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë, i cili do të jetë kriteri i çmimit të kontratës për blerjen e shërbimeve të shëndetësisë.

Respektivisht: Shërbuesi i Shëndetësisë, Shërbuesi i Shëndetësisë, Shërbuesi i Shëndetësisë, Shërbuesi i Shëndetësisë, Shërbuesi i Shëndetësisë.

2024-09-10

Duke marr për bazë te gjitha faktet dhe provat lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, komisioni i vlerësimit, ekzamnimit dhe krahasimit te tenderve me rastin e eliminimit tone ka shkelur **nenin 59 par. 1 te LPP-se, dhe rregulloren 39.5 te RR. Nr. 001/2022 per PP** sepse komisioni i vlerësimit duhet te posedoje aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit, dhe ne rastin



e vlerësimit ka deshtuar duke vepruar ne kundërshtim me keto dispozita ligjre te LPP-se.

Andaj Kemi kërkuar nga AK Zyra e Kryeministrit të aprovoj kërkesën tonë dhe të respektoj dispozitat ligjore dhe të vendos komision profesional me aftësitë e duhura, njohuritë dhe përvojën për ti vlerësuar mostrat.

Por pavarisisht kësaj AK – Zyra e Prokurimit ka shkelur **nenin 39.11 te Rr. Nr. 001/2022 PP të ndryshuar me Rr. 001/2024**, sepse nuk është dashur të pajtohet me komisionin e vlerësimit por, te asistoj dhe nese eshte nevoja edhe te ndryshoj komisionin e vlerësimit dhe te respektohne ne teresi dispozitat ligjore te LPP-së

Duke pasur parasysh që AK me rastin e vlerësimit të mostrave nuk ka caktuar një komision të pavarur për inspektimin e mostrave sikur është kërkuar në nenin 37 ë Rregullorës në fuqi të Prokurimit por inspektimin e ka bërë komisioni i vlerësimit të tenderit, kërkojmë nga OSHP që me rastin e shqyrtimit të ankesës të caktoj një ekspert teknik profesional për inspektimin e mostrave në mënyrë që të dëshmohet që mostra e dorëzuar nga ana jonë është në përputhje me specifikat e kërkuara nga AK ndërsa mostra e O.E. të rekomanduar nuk i ka plotësuar specifikat teknike të kërkuara nga AK.

**Duke u bazuar në nenin 106 të LPP-s, si dhe në rrethanat dhe faktet e cekura më lartë, kërkojmë nga OSHP që të urdhëroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht ta pezulloj aktivitetin e prokurimit në fjalë, të shqyrtoj faktet e paraqitura në ankesën tonë dhe pas vërtetimit të fakteve të cekura më lartë te merr:**

#### **VENDIM**

**APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE: Mobelland SH.P.K.**

**ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per dhenie te kontrates dhe lënda te kthehet ne RIVLERESIM dhe të urdhërohet Autoriteti kontraktues që gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave, vlerësimi te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave ligjore te LPP-së në mënyrë që të rishqyrtojnë vendimin me të cilin kanë propozuar për kontratë një operator ekonomik të pa përgjegjshëm dhe me çmim më të lartë se oferta jonë dhe të merren parasysh dokumentet e ofruara në tenderin tonë të cilat dëshmojnë që kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm.**

#### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Duke pasur parasysh shkeljet të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues si më lartë, neve do të na shkaktohen dëme materiale sepse për përgatitjen e tenderit janë bërë shpenzime të konsiderueshme, shpenzime të përgatitjes së kësaj kërkesë si dhe fitimi i humbur për shkak se ne kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve të përgjegjshëm për këtë tender.

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.



- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
  - d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
  - e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
  - f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
  - g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- \*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.